

Fjala Përshëndetëse

Ambasadori Hellmut Hoffmann

Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë

Tiranë, 22 nëntor 2013

Z. President i Republikës së Shqipërisë,

Z. Kryetar i Kuvendit,

Z. Kryeministër,

Z. Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,

Kolegë,

Zonja dhe Zotërinj,

Ndjehem i nderuar të them disa fjalë në hapjen e punimeve të kësaj konference kaq të rëndësishme, të organizuar me rastin e 15 vjetorit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Së pari, më duhet të them se si Ambasadori gjerman jam sigurisht i kënaqur që një fondacion gjerman është një prej bashkëorganizatorëve të kësaj konference. Prandaj, do të dëshiroja të shprehja vlerësimin dhe mirënjohjen time të veçantë për Fondacionin “Hanns Seidel”.

E vlerësoj së tepërmi faktin se Fondacioni “Hanns Seidel” është aktiv në këtë fushë, pasi fryma dhe praktika e kushtetutës është në zemër të çdo shteti demokratik dhe në funksion të sundimit të ligjit.

Reflektimi mbi origjinën e procesit kushtetues të kushtetutës ende të re të Shqipërisë, dhe vështrimi mbi sfidat aktuale dhe të ardhshme me të cilat ajo përballet, mendoj se është një përpjekje që vlen të ndërmerret.

Gjatë përgatitjes për evenimentin e sotëm, mësova me kënaqësi nga një ekspert i shquar shqiptar se etërit e Kushtetutës së Shqipërisë, ndërmjet kushtetutave të vendeve të tjera, janë orientuar edhe nga Kushtetuta gjermane apo Ligji Themeltar (“Grundgesetz”), sikurse e quajmë ne kushtetutën tonë për arsye historike.

Po ashtu, mësova me kënaqësi se mënyra e konceptimit nga Kushtetuta shqiptare e rolit të një sërë institucionesh të rëndësishme është frymëzuar, ndërmjet të tjerash, edhe nga Ligji Themeltar

gjerman, sikurse është roli i parlamentit, roli i presidentit dhe krijimi i gjykatës kushtetuese. Më thanë edhe se kapitulli për të drejtat e njeriut evokon modelin e Ligjit Themeltar.

Si student i shkencave politike disa dekada më parë, një prej gjërave më themelore që më mësuan ishte të qenit vigjilent për çdo ndryshim të mundshëm midis të drejtës kushtetuese nga njëra anë dhe realitetit kushtetues nga ana tjetër (“Verfassungsrecht und Verfassungswirklichkeit”).

Mendoj se është e drejtë të thuhet se është pjesë e detyrës së diplomatëve të përpiqen ta kuptojnë dhe analizojnë me saktësi atë që ndodh në vendet ku ata janë të akredituar.

Shqipëria ka kaluar një transformim masiv dhe rrënjësor në rreth 20 vjet, i cili ka prekur praktikisht çdo sferë – politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore.

Duke qenë se kam ardhur në Tiranë vetëm pak muaj më parë, duhet të jem i kujdesshëm në gjykimin tim, por më duket se në pamje të parë Kushtetuta e Shqipërisë ka treguar se ka shërbyer mirë gjatë 15 viteve të fundit me qëllim garantimin e stabilitetit nga njëra anë dhe lejimin e zhvillimit nga ana tjetër, duke cituar nocionet kryesore të titullit të kësaj konference.

Sot, Shqipëria është në rrugën e saj drejt Bashkimit European, një objektivi që mbështetet plotësisht nga Gjermania.

Kush do ta kishte menduar vetëm 10 apo 15 vite më parë se Shqipëria do të ishte sot në rrugën drejt Bashkimit European? Kjo gjë tregon në fakt progresin e jashtëzakonshëm që ka bërë Shqipëria.

Me qëllim nxitjen e mëtejshme të këtij objektivi, për realizimin e të cilit forcimi i shtetit të së drejtës është një çështje me rëndësi primare, mbetet vetëm të mirëpresim ngrohtë faktin që përfaqësuesit më të lartë të institucioneve shtetërore dhe sistemit gjyqësor, akademikë të shquar të së drejtës kushtetuese mblidhen së bashku për të reflektuar mbi situatën në të cilën ndodhet sot Shqipëria, për sa i përket të drejtës kushtetuese dhe zhvillimit të realitetit kushtetues gjatë 15 viteve të ekzistencës së Kushtetutës.

Pra, më lejoni të përfundoj duke ju uruar prezantime dhe diskutime të frytshme, të cilat do të ndihmojnë në konsolidimin dhe promovimin e mëtejshëm të teorisë dhe praktikës së sistemit kushtetues në Republikën e Shqipërisë. Faleminderit.